

RAPORT MONITORIMI I POLITIKËS

Përfaqësimi Etnik në Arsimin Para-Universitar

Komuna e Prizrenit

Autore: Albanota Hyseni

Rishikues: KYC Kosova

Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"

"Social Urban Innovation Kosova"

Të drejtat e autorit © 2025. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Përfaqësimi Etnik në Arsimin Para-Universitar

Rasti Shembull - Komuna e Prizrenit



Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Unicef Kosovo Programme, IOM Kosovo dhe Peacebuilding Fund, si produkt i iniciativës së implementuar nga KYC Kosova dhe Këshilli i Nxënësve të Prizrenit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

Hyrje

Përfaqësimi etnik në shkolla është një element thelbësor për krijimin e një mjedisi arsimor gjithëpërfshirës dhe të barabartë. Në komunën e Prizrenit, ku bashkëjetojnë komunitete të ndryshme si shqiptarët, turqit, romët dhe të tjerë, sigurimi i një qasjeje të barabartë në arsim është jetik për ndërtimin e një shoqërie të integruar dhe të harmonizuar.

Ky raport monitorimi synon të analizojë situatën aktuale të përfaqësimit etnik në shkollat e Prizrenit, duke vlerësuar nëse politikat ekzistuese janë të qarta dhe si zbatohen ato në praktikë. Përveç kësaj, raporti do të identifikojë sfidat dhe mangësitë ekzistuese dhe do të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e përfaqësimit etnik dhe forcimin e bashkëpunimit ndëretnik në sistemin arsimor të komunës.

Rezultatet e këtij monitorimi do të jenë një burim i rëndësishëm për shkollat, Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), politikëbërësit dhe organizatat e shoqërisë civile, duke ndihmuar në marrjen e masave më efektive për të garantuar një mjedis arsimor të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar për të gjitha komunitetet.

Analizë e ligjeve dhe politikave ekzistuese

Ligji 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve në Kontekstin e Përfaqësimit Etnik në Arsim

- Ky ligj është një instrument kyç për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, duke përfshirë aspektin e arsimit. Korniza ligjore garanton të drejtat arsimore për komunitetet joshumicë përmes disa dispozitave kyçe. Neni 8.1 siguron të drejtën për shkollim në gjuhën amtare të komuniteteve, edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare. Në rast se nuk ka klasa të mjaftueshme në gjuhën e komuniteteve, Neni 8.2 parashikon alternativa si transport të subvencionuar ose shkollim në distancë. Neni 8.8 kërkon që mësimdhënësit të jenë të trajnuar në gjuhët e komuniteteve për të siguruar cilësi në arsim. Përfaqësimi i komuniteteve në menaxhimin e shkollave rregullohet nga Neni 8.9, i cili përcakton se drejtuesit dhe mësuesit duhet të pasqyrojnë përbërjen etnike dhe të njohin identitetin kulturor të komunitetit. Sipas Nenit 8.10, nxënësit që ndjekin mësimet në një gjuhë jozyrtare duhet të mësojnë të paktën një nga gjuhët zyrtare të Kosovës. Për të promovuar tolerancën dhe diversitetin, Neni 8.12 kërkon përfshirjen e kulturës dhe historisë së komuniteteve në plan-programin shkollor.

Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në Arsim

- garanton të drejtën e qytetarëve për të mësuar në gjuhën e tyre zyrtare të zgjedhur dhe synon të sigurojë qasje të barabartë në arsim për komunitetet që flasin gjuhë të ndryshme. Sipas Nenit 19.2 dhe 19.3, çdo person ka të drejtë të zgjedhë gjuhën e tij të preferuar për arsim dhe të regjistrojë fëmijën në një shkollë që e ofron atë gjuhë si gjuhë mësimore. Në rastet kur nuk ka shkolla që ofrojnë mësim në gjuhën e një komuniteti, Neni 19.4 përcakton se Ministria e Arsimit duhet të marrë masa për të siguruar arsimin e duhur, përfshirë transportin e subvencionuar, shkollimin në distancë ose hapjen e klasave të reja. Ky ligj synon të mbrojë dhe promovojë diversitetin gjuhësor në sistemin arsimor të Kosovës.

Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit (2019-2023)

- adreson sfidat kryesore në arsim për këto komunitete. Ai evidenton pjesëmarrjen e ulët në arsimin parashkollor, me vetëm 65 fëmijë të regjistruar, duke theksuar nevojën për ndërgjegjësim dhe mbështetje logjistike. Në arsimin fillor, janë të regjistruar 950 nxënës, ndërsa në arsimin e mesëm, 280 nxënës, me një shkallë të lartë braktisjeje, veçanërisht te vajzat për shkak të martesave të hershme dhe faktorëve ekonomikë. Plani përfshin gjithashtu rëndësinë e Qendrave Mësimore, ku 247 fëmijë marrin ndihmë akademike, si dhe sfidat në arsimin e lartë, ku vetëm 40 studentë e kanë përfunduar universitetin. Dokumenti nënvizon nevojën për mbështetje financiare, qasje më të mirë në arsim dhe politika të veçanta për të ulur braktisjen shkollore dhe për të përmirësuar suksesin akademik të këtyre komuniteteve.

Analiza e përfaqësimit etnik të nxënësve dhe mësimeve në Komunën e Prizrenit

Analizojmë ndryshimet midis viteve shkollare 2022-2023 dhe 2023-2024 në lidhje me përfaqësimin e nxënësve dhe mësimeve sipas përkatësisë etnike në komunën e Prizrenit. Krahësimi bazohet në të dhënat zyrtare të publikuara për secilin vit dhe synon të nxjerrë në pah tendencat kryesore, ndryshimet numerike dhe ndikimin e tyre në sistemin arsimor të kësaj komune.

Nxënësit në arsimin e mesëm të lartë:

Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në Prizren ka pësuar një rënie midis dy viteve shkollare. Në vitin 2022-2023, numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë nivel ishte 5,825, ndërsa në vitin 2023-2024 ky numër ka rënë në 5,643. Kjo tregon një ulje prej 182 nxënësish.

Nxënësit në gjimnaze dhe shkolla profesionale

Shkollat profesionale: Numri i nxënësve ka rënë nga 3,730 në vitin 2022-2023 në 3,643 në 2023-2024, duke shënuar një rënie prej 87 nxënësish.

Gjimnazet: Numri i nxënësve ka pësuar një ulje nga 2,095 në 2,000, me një diferencë prej 95 nxënësish.

Këto të dhëna tregojnë se rënia e regjistrimeve është më e theksuar te gjimnazet, duke sugjeruar se gjithnjë e më shumë nxënës mund të po orientohen drejt tregut të punës pas shkollimit fillor ose po përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale që i pengojnë të vazhdojnë shkollimin.

Përfaqësimi i nxënësve sipas përkatësisë etnike:

Sa i përket përkatësisë etnike të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, janë vërejtur disa ndryshime midis viteve:

- **Nxënësit shqiptarë:** Numri i tyre ka rënë nga 5,056 në vitin 2022-2023 në 4,858 në 2023-2024, duke shënuar një ulje prej 198 nxënësish.
- **Nxënësit turq:** Ky komunitet ka shënuar një rritje nga 298 në 345 nxënës, një shtim prej 47 nxënësish.
- **Nxënësit boshnjakë:** Numri i tyre ka rënë nga 440 në 430, me një rënie prej 10 nxënësish.

- **Nxënësit goranë:** Kanë shënuar një rritje të vogël nga 1 në 4 nxënës, një ndryshim simbolik, por domethënës për këtë komunitet të vogël.
- **Nxënësit ashkali:** Në vitin 2022-2023 kishte 7 nxënës ashkali, ndërsa në vitin 2023-2024 nuk ka të dhëna për këtë komunitet, duke sugjeruar një ulje të përfshirjes së tyre.
- **Nxënësit rom:** Në vitin 2022-2023 kishte 23 nxënës rom, ndërsa në 2023-2024 nuk figuron asnjë nxënës i këtij komuniteti, një rënie që tregon nevojën për masa përfshirëse.
- **Nxënësit egjiptianë:** Në vitin 2022-2023 nuk kishte nxënës egjiptianë të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, ndërsa në 2023-2024 është regjistruar 1 nxënës nga ky komunitet.

Mësimdhënësit sipas përkatësisë etnike

Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në komunën e Prizrenit ka pësuar një rënie të vogël, nga 2,286 në vitin 2022-2023 në 2,277 në 2023-2024 (9 mësimdhënës më pak).

Ndryshimet sipas përkatësisë etnike janë si më poshtë:

- **Mësimdhënësit shqiptarë:** Numri i tyre ka pësuar një ulje nga 1,901 në 1,855, pra 46 mësimdhënës shqiptarë më pak.
- **Mësimdhënësit turq:** Ky komunitet ka shënuar një rritje nga 110 në 126 mësimdhënës, një rritje prej 16 mësimdhënësish.
- **Mësimdhënësit boshnjakë:** Numri i tyre është rritur nga 265 në 345, një rritje e ndjeshme prej 80 mësimdhënësish, që tregon një përmirësim të përfaqësimit të këtij komuniteti në mësimdhënie.
- **Mësimdhënësit goranë:** Kanë mbetur të njëjtë në të dy vitet, me 3 mësimdhënës.
- **Mësimdhënësit ashkali dhe romë:** Në vitin 2022-2023 kishte 7 mësimdhënës nga këto komunitete, ndërsa në vitin 2023-2024 nuk figuron asnjë, duke treguar mungesë përfaqësimi për këto grupe etnike.
- **Mësimdhënësit kroatë:** Në vitin 2022-2023 kishte 2 mësimdhënës kroatë, ndërsa në 2023-2024 nuk ka më asnjë.

Identifikimi i problematikave në përfaqësimin etnik në arsimin e Komunës së Prizrenit

Bazuar në analizën e të dhënave mbi përfaqësimin etnik të nxënësve dhe mësimeve në arsimin e mesëm të lartë në komunën e Prizrenit, janë identifikuar disa boshllëqe dhe sfida kryesore që ndikojnë në implementimin e politikave për diversitetin dhe përfshirjen etnike në arsim.

Mungesa e përfaqësimit të disa komuniteteve në arsim – Të dhënat tregojnë një rënie të ndjeshme të përfaqësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si të nxënësve, ashtu edhe të mësimeve. Në veçanti, mungesa e nxënësve rom dhe ashkali nga arsimi i mesëm tregon se strategjitë për mbajtjen e tyre në shkollë nuk po funksionojnë siç duhet.

Mospërputhja midis qëllimeve politike dhe realitetit në terren – Megjithëse ekzistojnë fonde dhe programe për mbështetjen e arsimit për komunitetet e marginalizuara, numri i nxënësve që përfitojnë bursa apo mbështetje tjetër financiare është i ulët.

Mungesa e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit – Nuk ka të dhëna të plota nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) për suksesin akademik të nxënësve të komuniteteve pakicë. Kjo mungesë informate e bën të vështirë vlerësimin e progresit të politikave arsimore dhe ndërtimin e strategjive të reja për përmirësimin e situatës.

Qendrat Mësimore (QM) si mjet për përfshirje – Në Prizren funksionojnë 11 qendra mësimore që ndihmojnë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me mësim plotësues. Megjithatë, këto qendra mbështeten kryesisht nga organizata joqeveritare.

Përfshirja e mësimeve nga komunitetet pakicë – Mësimdhënësit janë faktor kyç për promovimin e diversitetit dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës. Megjithatë, mungesa e mësimeve rom dhe ashkali nga sistemi arsimor në vitin shkollor 2023-2024 dhe mungesa e mësimeve kroatë tregon se nuk ka një strategji të mirëfilltë për të nxitur përfaqësimin e komuniteteve të vogla në staf.

Mungesa e aktiviteteve ndërkulturore – Në shumicën e shkollave mungojnë aktivitete që promovojnë kulturën dhe historinë e komuniteteve pakicë, duke bërë që nxënësve nga këto komunitete të ndihen të përjashtuar ose të mos kenë hapësirë për të shprehur identitetin e tyre.




Vështirësitë ekonomike – Një pjesë e madhe e familjeve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përballen me kushte të rënda ekonomike, gjë që ndikon në vijueshmërinë e fëmijëve në shkollë. Mungesa e mbështetjes financiare të mjaftueshme për nxënësit e këtyre komuniteteve rrit rrezikun e braktisjes së shkollës, sidomos tek vajzat, të cilat përbëjnë 80% të atyre që nuk e vijojnë arsimin e mesëm.

Diskriminimi dhe stigmatizimi – Disa nxënës të komuniteteve pakicë mund të përballen me paragjykime nga bashkëmoshatarët ose edhe nga personeli shkollor, çka mund të ndikojë në motivimin dhe suksesin e tyre në shkollë.

Mungesa e materialeve mësimore të përshtatura për komunitetet pakicë – Në shumë raste, kurrikula nuk reflekton historinë dhe kulturën e komuniteteve të ndryshme etnike, duke bërë që këta nxënës të mos ndihen të përfaqësuar në sistemin arsimor.

Rekomandime

- **Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit** - Duhet të krijohet një sistem i rregullt mbledhjeje të të dhënave për vijueshmërinë dhe suksesin akademik të nxënësve nga komunitetet pakicë, me qëllim vlerësimin e ndikimit të politikave arsimore.
- **Rritja e numrit të bursave për nxënësit e komuniteteve të marginalizuara** - Bursat duhet të jenë më të shumta dhe të lehta për t'u aksesuar nga nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe për të siguruar mundësi të barabarta në arsim.
- **Angazhimi i më shumë mësimitdhënësve nga komunitetet pakicë** - Duhet të krijohet një politikë për të stimuluar punësimin e mësimitdhënësve nga komunitetet e vogla etnike, duke siguruar përfaqësim të drejtë dhe një mjedis më të mirë mësimor.
- **Zhvillimi i aktiviteteve ndërkulturore në shkolla** - Krijimi i festivaleve, programeve edukative dhe orëve mësimore që promovojnë kulturën e komuniteteve të ndryshme, mund të ndihmojë në integrimin më të mirë dhe respektimin e diversitetit kulturor.
- **Ofrimi i klasave në gjuhë të komunitetit dhe rritja e numrit të mësuesve të kualifikuar** - Duhet të rritet numri i klasave që ofrojnë mësim në gjuhët e komunitetit, dhe të sigurohet që mësuesit të jenë të kualifikuar për të mësuar në këto gjuhë.
- **Integrimi i historisë dhe kulturës së komuniteteve në programet arsimore** - Krijimi i moduleve për historinë dhe kulturën e komuniteteve të ndryshme do të ndihmojë nxënësit të kuptojnë dhe respektojnë diversitetin.
- **Krijimi i programeve të posaçme për mësimitdhënësit nga komunitetet e vogla etnike** - Përcaktimi i kriterëve fleksibël për hapjen e klasave në gjuhët e komunitetit dhe ofrimi i bursave për studentët që dëshirojnë të bëhen mësimitdhënës për gjuhët e komunitetit të tyre.
- **Mbështetje dhe trajnime për mësimitdhënësit në diversitetin kulturor dhe gjithëpërfshirjen** - Organizimi i trajnimeve për mësimitdhënësit mbi rëndësinë e diversitetit kulturor dhe gjithëpërfshirjes, duke siguruar që të gjitha grupet etnike të kenë mundësi të barabarta në arsim.
- **Rritja e monitorimit nga institucionet** - Duhet të rritet monitorimi nga institucionet përgjegjëse për të siguruar që të gjitha komunitetet të kenë mundësi të barabarta dhe që politika arsimore të zbatohet në mënyrë të drejtë dhe efektive.



Prishtinë, 2025